



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA
PRANË GJYKATËS SË APELIT ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM
V L O R Ë

R A P O R T
MBI TREGUESIT E PUNËS PËR VITIN 2018
TË PROKURORISË SË APELIT V L O R Ë

Nëpërmjet këtij materiali, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Vlorë, në vijim Prokuroria e Apelit Vlorë, **analizon treguesit kryesorë** të punës së kryer gjatë vitit 2018, në përfaqësimin e akuzës në çështjet e ankimuarra në Gjykatën e Apelit Vlorë, si dhe zbatimin e detyrimeve të tjera të parashikuara në ligj, nga personeli i kësaj zyre.

1. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË PËRFAQËSIMIN E AKUZËS NË GJYKIM.

Gjatë vitit 2018, nga i gjithë personeli i Prokurorisë së Apelit Vlorë është treguar kujdesi i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve ligjore në përfaqësimin e akuzës gjatë gjykimit në apel, po ashtu edhe për zbatimin e detyrimeve të tjera ligjore sikurse do të analizohen më hollësisht në vijim.

1.1. Lidhur me **respektimin e afateve ligjore**, gjatë vitit 2018, nga Prokuroria e Apelit Vlorë janë respektuar me korrektesë detyrimet e ligjit procedural penal, si dhe urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, për respektimin e afateve në shqyrtimin e çështjeve të ankimuarra.

Sa më sipër kryesisht, por jo vetëm, për :

- prezencën e prokurorëve në të gjitha seancat gjyqësore në Gjykatën e Apelit, si për çështjet e themelit, për masat e sigurimit apo ankimet e veçanta, duke respektuar solemnitetin dhe etikën në gjykim,
- për nxjerrjen në kohë të urdhërave të ekzekutimit në zbatim të vendimeve të Gjykatës së Apelit,

- dërgimin e vendimeve penale në Prokuroritë e rretheve gjyqësore kompetente,
- ushtrimin brenda afateve ligjore të së drejtës së rekursit në Gjykatën e Lartë, si dhe njoftimin e këtij akti edhe Drejtorisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka patur raste të moszhvillimit të seancave gjyqësore për shkak të mungesës për arsye joobjektive të prokurorëve, apo vonesa të tjera.

Gjithashtu nuk ka patur asnjë rast gjatë vitit 2018 që ndaj prokurorëve, apo punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Apelit Vlorë, të jetë inicuar procedimi disiplinor apo të jenë marrë masa disiplinore nga organet kompetente sipas ligjit.

1.2. Gjatë kësaj periudhe kohore, ka qenë në vëmendjen e prokurorëve respektimi i parashikimeve të **Rezolutës së Kuvendit** të Shqipërisë dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj, zbatimi i **rekomandimeve të Këshillit të Ministrave**, si dhe **udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm** për luftën kundër kriminalitetit, në drejtim të kërkimeve penale në gjykimin e çështjeve në Gjykatën e Apelit Vlorë, në fokus të atyre rekomandimeve dhe udhëzimeve.

1.3 Përmbajtja e atyre akteve, përveçse është shpërndarë tek çdo prokuroror, është punuar edhe në mbledhje të përbashkëta të prokurorëve të kësaj zyre.

1.4. Në zbatim të detyrimeve të ligjit penal dhe rekomandimeve të akteve të lartpërmendura, për veprat penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si për veprat penale kundër jetës së personit, kundër pasurisë, veprën penale të dhunës në familje, ato që lidhen me krimin ekonomik apo abuzimin me detyrën nga zyrtarët shtetërore, veprat penale që lidhen më narkotikët etj, kërkimet e prokurorëve të apelit për masat e sigurimit dhe gjykimet e themelit, kanë qenë në mbështetje të provueshmërisë së akuzave dhe për sanksione të larta dënimi.

1.5. Ndërkohë që në rastet e parashikuara nga ligji dhe kur vendimet e Gjykatës së Apelit kanë qenë të ndryshme nga kërkimet e akuzës, është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë për çështjet respektive.

1.6. Lidhur me **bashkëpunimin me institucionet e tjera**, gjatë vitit 2018 kanë vijuar raportet korrekte me institucione të tjera, në zbatim të ligjit procedural dhe atij organik për Prokurorinë. Në keto marrëdhënie rolin kryesor e zënë ato që lidhen me :

- Gjykatën e Apelit Vlorë, për fazën që lidhet me përfaqësimin e akuzës në gjykimin e çështjeve të ankimuara, si dhe të detyrimeve të përbashkëta administrative për mbarëvajtjen e punës.
- Prokuroritë e rretheve gjyqësore, që veprojnë në juridiksionin e Apelit Vlorë, për bashkëveprimin në funksion të përfaqësimit sa më të mirë të akuzës në çështjet e ankimuara, veprimtarisë në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe detyrimeve të tjera ligjore të prokurorit.
- Strukturat e policisë së shtetit dhe institucionet e tjera që përfshijnë shërbime të policisë gjyqësore, për bashkëpunimin në gjykimin e çështjeve të ankimuara dhe zbatimin e urdhërave për ekzekutimin e vendimeve penale.
- Me Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për fazën e ekzekutimit.
- Me Prokurorinë e Përgjithshme, si institucioni që përfaqëson çështjet e rekursuara, si dhe në bashkëpunimin për çështje të tjera të natyrës administrative.
- Me institucionet e tjera, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore.

1.7. Bashkëpunimi me Gjykatën e Apelit Vlorë.

Sikurse u përmend edhe më sipër, raportet e kësaj zyre me Gjykatën e Apelit Vlorë, kanë qenë korrekte dhe ligjore, në përfaqësimin e akuzës në gjykimet në apel dhe plotësimin e detyrimeve të tjera ligjore. Nga ana e prokurorëve, nisur edhe nga fakti që dy institucionet ndodhen në të njëjtën godinë, është respektuar me korrektesë pjesëmarrja e tyre në kohën në gjykim, ndërkohë që nga ana tjetër edhe nga kolegjet gjyqësore është konstatuar angazhim i plotë për mbarëvajtjen e gjykimeve, respektimin e solemnitetit të tij, ruajtjen e sekretit për vendimet që lidhen me akte të asaj natyre të hetimeve paraprake etj.

1.8. Po ashtu një vëmendje e posaçme i është kushtuar përmbushjes së detyrimeve të përbashkëta ligjore në fushën e administrimit të drejtësisë, sikurse përpjekjet e përbashkëta për rritjen e nivelit të sigurisë në godinë, transparencën ndaj publikut nëpërmjet afishimit paraprakisht të listave të gjykimeve penale në apel etj.

1.9. Bashkëpunimi me Prokuroritë e rretheve gjyqësore të juridiksionit të Apelit Vlorë.

Edhe gjatë vitit 2018 kanë vijuar raportet e ngushta të bashkëpunimit me ta gjitha Prokuroritë e rretheve të juridiksionit të apelit, për trajtimin e problematikave që hasen në gjykimin e çështjeve të ankimuara, si për qëllime të rritjes së nivelit cilësor të apeliemeve, shkëmbimit të informacioneve për fazën e çështjeve konkrete, trajtimin juridiko-penal të kazuseve të diskutueshme, dërgimit të njoftimeve për fazën e ekzekutimit të vendimeve penale etj.

Përmirësimit të punës në këtë drejtim i shërben edhe praktika e Prokurorisë së Apelit Vlorë, për përpilimin dhe mbajtjen e evidencave mujore të përfaqësimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit Vlorë, sipas rretheve përkatëse.

Gjatë kësaj periudhe kemi gjetur mirëkuptimin e plotë të drejtuesve dhe prokurorëve të zyrave përkatëse për përmirësimin e problematikave të hasura, si rritjen e nivelit cilësor të apeliemeve, parashtrimin të të gjitha shkaqeve ligjorë në to, ushtrimin e apeliemeve për masat e sigurimit vetëm për rastet e domosdoshme të hetimit paraprak, përmirësimin e komunikimit dhe njoftimit të zyrave respektive për rrethanat e gjykimit, në shkallën e parë dhe në apel etj.

Me ndryshimin e ligjit procedural penal, gjatë vitit 2018 nuk ka patur raste kur nga prokurorët e apelit të jetë autorizuar përfaqësimi i çështjeve në Gjykatën e Apelit nga prokurorët e shkallës së parë, sikurse ka ndodhur në vitet e mëparshme.

1.10. Bashkëpunimi me strukturat e Policisë së Shtetit.

Raportet me strukturat e policisë së shtetit në Drejtoritë vendore të policisë së qarqeve e Vlorë, Fier dhe Berat gjatë vitit 2018 kanë qenë tërësisht korrekte dhe ato janë shtrirë kryesisht në fushën e njoftimit të palëve në fazën e gjykimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimeve penale nga prokurorët e apelit, apo në fushën administrative në funksion të administrimit të drejtësisë.

1.10. Bashkëpunimi me Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Raportet me Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë, Fier dhe Berat, gjatë vitit 2018, kanë qenë bashkëpunuese dhe korrekte dhe ato janë shtrirë në të gjitha aspektet ku ligji e parashikon këtë bashkëpunim, përfshirë atë të njoftimeve, shkëmbimit të informacioneve të nevojshme për çështjet, në fushën e

ekzekutimit të vendimeve penale dhe në kompetencë të prokurorëve të apelit, sikurse janë ato për masat e sigurimit apo udhërimet e tjera të gjykatës etj.

1.11. Bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjatë vitit 2018 ka vijuar raporti i ngushtë i bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme.

Ky bashkëpunim është shtrirë jo vetëm me Prokurorin e Përgjithshëm dhe drejtorinë gjyqësore, për dërgimin e rekurseve dhe informimin nga prokurorët pranë Gjykatës së Lartë për mënyrën e përfundimit të tyre, apo drejtorinë e marrëdhënieve me jashtë për shkëmbimin e të dhënave në atë fushë, por edhe me të gjitha drejtoritë dhe sektorët e tjerë të Prokurorisë së Përgjithshme.

Pikërisht edhe në sajë të këtij bashkëpunimi dhe plotësimit të nevojave administrative nga sektorët e tjerë të Prokurorisë së Përgjithshme, është bërë e mundur përballimi i një volumi të konsiderueshëm në punë nga Prokuroria e Apelit Vlorë.

Gjatë vitit 2018 ka vijuar praktika e mirë e viteve të mëparshme që rekursat e prokurorëve të apelit, si për masat e sigurimit dhe për vendimet përfundimtare, krahas depozitimit në gjykatë dërgohen paralelisht për njoftim edhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

Edhe gjatë vitit 2018 janë respektuar detyrimet e prokurorëve për të zbatuar në kohë dhe me cilësi urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me ushtrimin e funksioneve të prokurorit në apel.

1.12. Bashkëpunimi me institucionet e tjera.

Gjatë vitit 2018 përfaqësimi i Prokurorisë së Apelit në raport me institucionet e tjera, në zbatim të detyrimeve të ligjit organik për Prokurorinë, është përmbushur në mënyrë korrekte.

2. ANALIZA E TREGUESVE TË VOLUMIT TË PUNËS.

Treguesit e volumit të punës për vitin 2018, të cilat përfshijnë edhe çështjet e mbartura nga viti 2017 dhe të dhënat për veprën penale të dhunës në familje për të cilën mbahet statistikë e veçantë, paraqiten si në vijim.

2.1 Në total gjatë vitit 2018, nga prokurorët e Apelit është përfaqësuar akuza në çështjet në gjykim pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për **1956 çështje** nga të cilat :

- **789** çështje themeli, prej të cilave 105 janë për dhunë në familje,
- **333** çështje të masave të sigurimit,
- **834** çështje mbi ankime të veçanta, si ankime kundër vendimeve të pushimit apo mosfillimit, të fazës së ekzekutimit të vendimeve penale, marrëdhëniet juridikionale me jashtë, me të dëmtuar akuzes etj.
- Për **42** çështje prokurorët e shkallës së parë kanë ushtruar të drejtën e **apelimit kundërshtues**.
- **100** çështje janë **mbartur** në gjykim për vitin 2019, por pjesa më e madhe e të cilave janë përfunduar në momentin e këtij raportimi.

2.2. Nga këndvështrimi **krahasimor** me volumin e punës të përballuar në vitin **2017**, të dhënat e volumit të punës rezultojnë më të larta duke qenë se në atë vit prokurorët e kanë përfaqësuar akuzën në Gjykatën e Apelit Vlorë për **1720** çështje.

2.3. Nisur nga volumi i natyrës së çështjeve, faktori kryesor që ka ndikuar në shtimin e numrit të çështjeve gjatë vitit 2018 ka qenë numri i lartë i çështjeve të seancës paraprake, pas ndryshimeve me ligjin nr. 35 / 2017 në Kodin e Procedurës Penale.

2.4. Ndërkohë për vitin **2018** paraqitet paksa më i lartë se viti i kaluar treguesi i çështjeve të **mbartura** në gjykim, për shkak edhe të reduktimit të numrit të gjyqtarëve në apel, por ky tregues gjithsesi rezulton i **përmirësuar dukshëm** me vitet paraardhëse, pasi mjafton të kujtojmë që në vitin 2015 ky numër ishte **790** çështje.

2.5. Gjithashtu gjatë vitit 2018, nga prokurorët e apelit janë kryer detyrimet ligjore në fushën e **ekzekutimit të vendimeve** penale, ku janë **122** raste të nxjerrjes së urdhërave të ekzekutimit, që lidhen me vendimet me ekzekutim të menjëhershëm të Gjykatës së Apelit Vlorë, për rastet në vijim :

- **18** urdhëra ekzekutimi ndaj personave që u është ndryshuar masa e sigurimit me e butë e caktuar në shkallën e parë, me masën e sigurimit arrest në burg (në vitin 2017 ishin 17 urdhëra të tillë ekzekutimi).
- **99** urdhëra ekzekutimi ndaj personave që u është ndryshuar masa e sigurimit me një masë të butë nga arresti në burg (në vitin 2017 ishin 128 urdhëra të tillë ekzekutimi).

- **5** urdhëra ekzekutimi ndaj personave që u janë caktuar apo ndryshuar masa të tjera sigurimi nga arresti, si në shkallën e parë dhe në apel (në vitin 2017 ishin 17 urdhëra të tillë ekzekutimi).

Ndërkohë në vitin 2017 janë ekzekutuar 162 vendime penale nga prokurorët e apelit.

3. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS PËR ÇËSHTJET E THEMELIT.

3.1. Për **çështjet e themelit**, në total, gjatë vitit 2017 nga prokurorët është përfaqësuar akuza në Gjykatën e Apelit Vlorë për **789 çështje** (vitin paraardhës ishin 934), me **1027** persona të **pandehur**, nga të cilët **416** kanë qenë të **arrestuar** dhe sipas rretheve gjyqësorë të dhënat paraqiten si vijon :

- **Vlorë** – **294** çështje, **398** të pandehur, **173** të arrestuar.
- **Fier** – **250** çështje, **324** të pandehur, **106** të arrestuar.
- **Berat** – **167** çështje, **209** të pandehur, **85** të arrestuar.
- **Lushnjë** – **78** çështje, **96** të pandehur, **52** të arrestuar.

3.2. Nga numri total i çështjeve të themelit të përfaqësuar në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe që u përmendën hollësisht më sipër, për **267** prej tyre **apelues** kanë qenë **Prokuroritë** e shkallës së parë, kurse për pjesën tjetër apelues kanë qenë të pandehurit, ku sipas rretheve gjyqësorë të dhënat paraqiten si vijon :

- Prokuroria e rrethit gjyqësor **Vlorë** – **199** apeline të prokurorëve.
- Prokuroria e rrethit gjyqësor **Fier** – **65** apeline të prokurorëve.
- Prokuroria e rrethit gjyqësor **Berat** – **90** apeline të prokurorëve.
- Prokuroria e rrethit gjyqësor **Lushnjë** – **13** apeline të prokurorëve.

3.3. Për çështjet ku apelues ka qenë prokurori, të dhënat paraqiten si vijon :

- **50 apeline** të prokurorëve të shkallës së parë, kanë qenë për **pafajësi** ndaj të pandehurve (Vlora – **22**, Fieri – **9**, Berati – **17**, Lushnja - **2**).
- **12 apeline** të prokurorëve të shkallës së parë, kanë qenë për **pushim** të çështjes apo akuzës.
- **205 apeline** të prokurorëve të shkallës së parë, kanë qenë për **lloj apo masë** dënimi të konsideruar të butë.

3.4. Ndër çështjet e apeluara, në **129** raste Gjykata e Apelit ka vendosur **mospranimin** e apelit, ndër të cilat në **42** raste është hequr dorë nga prokurorët e apelit (çka është thujse i njëjti numër me vitin e kaluar kur ishin 41 të tilla), kurse në **87** raste të tjera është disponuar **nga gjykata** për mosplotësim të shkaqeve formale të apelit.

3.5. Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **343** raste kërkesat e **prokurorit të apelit** kanë qenë për **lënje në fuqi** të vendimit të shkallës së parë, për të cilat Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur si vijon :

- në **240** çështje e ka **lënë në fuqi** vendimin,
- në **80** çështje e ka ndryshuar vendimin, duke **lehtësuar** pozitën e të pandehurit,
- në **20** raste e ka prishur vendimin dhe ka **pushuar** çështjen,
- në **3** raste e ka prishur vendimin dhe ka kthyer çështjen për **rigjykim**.

3.6. Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **182** raste kërkesat e **prokurorit të apelit** kanë qenë për ndryshim të vendimit të shkallës së parë dhe **rëndim** të pozitës së të pandehurit, për të cilat Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur si vijon :

- në **139** çështje e ka **lënë në fuqi** vendimin,
- në **24** çështje e ka ndryshuar vendimin duke **rënduar** pozitën e të pandehurit,
- në **14** çështje e ka ndryshuar vendimin duke **lehtësuar** pozitën e të pandehurit,
- në **4** raste e ka prishur vendimin dhe ka vendosur pafajësinë ose **pushimin** e çështjes,
- në **1** rast e ka prishur vendimin dhe ka kthyer çështjen për **rigjykim**.

3.7. Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **56** raste kërkesat e **prokurorit të apelit** kanë qenë për ndryshim të vendimit të shkallës së parë dhe **lehtësim** të pozitës së të pandehurit, nga të cilat janë **pranuar** në **54** raste dhe është **pushuar** çështja në **2** raste nga Gjykata e Apelit Vlorë.

3.8. Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **73** raste kërkesat e prokurorit të apelit kanë qenë për ndryshim të vendimit të shkallës së parë dhe **pushim të gjykimit**, kryesisht për rastet e ligjeve për **amnistinë**, të viteve 2015 dhe 2016, të cilat janë **pranuar** nga Gjykata e Apelit me përjashtim të 1 rasti kur vendimi është prishur dhe aktet janë kthyer për rigjykim në shkallën e parë.

3.9. Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **6** raste kërkesat e **prokurorit të apelit** kanë qenë për prishje të vendimit të shkallës së parë dhe rikthim të çështjes për **rigjykim**, nga të cilat Gjykata e Apelit ka vendosur si vijon :

- në të **6** rastet është pranuar kërkesa e prokurorit të apelit për kthim të çështjes për **rigjykim**.

3.10. Lidhur me ndarjen e ankimeve të palëve në Gjykatën e Apelit, për **krimet dhe kundravajtjet penale** të dhënat paraqiten si më poshtë :

- Për **643** çështje, me **815** të pandehur dhe **414** të arrestuar, apelimet kanë qenë për **krime**.
- Për **146** çështje, me **212** të pandehur dhe **2** të arrestuar, apelimet kanë qenë për **kundravajtje penale**.

3.11. Gjatë vitit 2018, prokurorët e apelit kanë ushtruar **rekurs** mbi vendimet për **çështjet e themelit** të Gjykatës së Apelit në **112** raste (vitin paraardhës ishin 151), ku sipas rretheve gjyqësore të dhënat janë si më poshtë :

- **44** rekurse për vendimet e rrethit të **Vlorës**,
- **34** rekurse për vendimet e rrethit të **Fierit**,
- **26** rekurse për vendimet e rrethit të **Beratit**,
- **8** rekurse për vendimet e rrethit të **Lushnjës**.

3.12. Gjatë vitit 2018, prokurorët e apelit kanë ushtruar **rekurs** edhe mbi vendimet për **çështjet e veçanta** të Gjykatës së Apelit në **17** raste, përfshirë çështje që lidhen me ekzekutimet e vendimeve penale, marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, rivendosjet në afat etj.

4. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS PËR ÇËSHTJET E MASAVE TË SIGURIMIT.

4.1. Në gjykimin e masave të sigurimit, **në total** gjatë vitit 2017 nga prokurorët është përfaqësuar akuza në Gjykatën e Apelit Vlorë për **423 persona** (vitin paraardhës ishin 455), ku sipas rretheve gjyqësore të dhënat paraqiten si në vijim :

- **145** persona për masa sigurimi nga Prokuroria e rrethit **Vlorë**,
- **154** persona për masa sigurimi nga Prokuroria e rrethit **Fier**,
- **93** persona për masa sigurimi nga Prokuroria e rrethit **Berat**,
- **31** persona për masa sigurimi nga Prokuroria e rrethit **Lushnjë**.

4.2. Nga ky numër i çështjeve të përfaqësuara në Gjykatën e Apelit, për **78** prej tyre **apelues** kanë qenë **Prokuroritë** e shkallës së parë, kurse për pjesën tjetër apelues kanë qenë të pandehurit, ku sipas rretheve gjyqësorë të dhënat paraqiten si vijon :

- Prokuroria e rrethit gjyqësor **Vlorë** – **17** apelime të prokurorëve.
- Prokuroria e rrethit gjyqësor **Fier** – **32** apelime të prokurorëve.
- Prokuroria e rrethit gjyqësor **Berat** – **27** apelime të prokurorëve.
- Prokuroria e rrethit gjyqësor **Lushnjë** – **2** apelime të prokurorëve.

4.3. Në **41** raste të **apelimeve** për masat e sigurimit, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur **mospranimin** e tyre, ndër të cilat në **15** raste është hequr dorë nga prokurori i apelit (vitin paraardhës ishin 13), ku sipas rretheve gjyqësore të dhënat paraqiten si vijon :

- Prokuroria e rrethit gjyqësor **Vlorë** – **17** vendime gjyqësore mospranimi, per **3** prej të cilave është hequr dorë nga prokurori,
- Prokuroria e rrethit gjyqësor **Fier** – **10** vendime gjyqësore mospranimi, per **7** prej të cilave është hequr dorë nga prokurori,
- Prokuroria e rrethit gjyqësor Berat – **11** vendime gjyqësore mospranimi, per **5** prej të cilave është hequr dorë nga prokurori,
- Prokuroria e rrethit gjyqësor Lushnjë – **3** vendime gjyqësore mospranimi.

4.4. Në **2** raste prokurori ka kërkuar **shfuqizimin** e vendimit që janë pranuar nga gjykata.

4.5. Në **77** raste të apelimeve për masat e sigurimit (Vlorë – 19, Fier – 31, Berat – 25, Lushnjë – 2), **prokurori i apelit** ka kërkuar **ndryshimin** e vendimit si vijon :

- Në **62** raste (Vlorë – 14, Fier – 23, Berat – 23, Lushnjë – 2) prokurori i apelit ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit **arrest në burg**, sipas apelit të prokurorit të shkallës së parë,
- Në **15** raste (Vlorë – 5, Fier – 8, Berat – 2) prokurori i apelit ka kërkuar caktimin e masave të sigurimit më të buta nga vendimi i shkallës së parë.

4.6. Për këtë kërkim të prokurorit të apelit, **Gjykata** e Apelit Vlorë ka **vendosur** si vijon :

- Në **20** raste (Vlorë – 7, Fier – 5, Berat –7, Lushnjë - 1) ka caktuar masën e sigurimit **arrest në burg**, sipas apelimit të prokurorit të shkallës së parë,
- Në **17** raste (Vlorë – 5, Fier – 9, Berat – 3) ka caktuar masa sigurimi më të **buta** nga vendimi i shkallës së parë.
- Në **40** raste (Vlorë – 7, Fier – 17, Berat – 15, Lushnjë – 1) ka **lënë në fuqi** vendimin e shkallës së parë.

4.7. Në **215** raste (Vlorë – 79, Fier – 77, Berat – 41, Lushnjë – 18), kryesisht për ankime të të hetuarve, **prokurori** ka kërkuar **lënien në fuqi** të vendimit të shkallës së parë.

4.8. Për këtë kërkim të prokurorit të apelit, **Gjykata** e Apelit Vlorë ka **vendosur** si vijon :

- Në **192** raste (Vlorë – 70, Fier – 68, Berat – 39, Lushnjë – 15) ka **lënë në fuqi** vendimin e shkallës së parë,
- Në **23** raste (Vlorë – 9, Fier – 9, Berat –2, Lushnjë – 3) ka caktuar masa sigurimi më të **buta** nga vendimi i shkallës së parë.
- Ndërkohë nuk ka patur raste të **shfuqizimit** të vendimin të shkallës së parë.

4.9. Për **23** çështje që lidhen me **masat e sigurimit**, prokurorët e apelit kanë ushtruar të drejtën e **rekursit** në Gjykatën e Lartë, ku sipas rretheve gjyqësore të dhënat paraqiten si vijon :

- **7** rekurse për vendime që lidhen me çështje të rrethit **Vlorë**,
- **6** rekurse për vendime që lidhen me çështje të rrethit **Fier**,
- **7** rekurse për vendime që lidhen me çështje të rrethit **Berat**,
- **3** rekurse për vendime që lidhen me çështje të rrethit **Lushnjë**.

5. TË DHËNAT MBI NGARKESËN E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR.

Gjatë vitit 2018 ngarkesa e punës për çdo prokuror ka qenë në nivele të përafërta, çka është tregues i një organizimi të mirë të brendshëm të punës dhe përbën përmbushje të detyrimit ligjor për ndarjen e barabartë të punës në Prokurori.

Përrjashtim nga sa më sipër përbën prokurori Petrit Qerimi, i cili ka dalë në pension në muajin gusht 2018, si dhe ngarkesa e drejtuesit të Prokurorisë, i cili në përmbushje edhe të detyrimeve të tjera ligjore ka patur ngarkesë disi më të ulët.

Të dhënat mbi ngarkesën e punës për çdo prokuror gjatë vitit 2018, në përfaqësimin e çështjeve të ndryshme në Gjykatën e Apelit Vlorë, paraqiten si në vijim.

5.1. Prokurori **Petrit Qerimi** :

- **60** përfaqësime për çështje **themeli**, ka ushtruar **rekurs për 17** prej tyre.
- **94** përfaqësime për çështje **të veçanta** (në të cilat përfshihen edhe ato të seancës paraprake dhe të kryera në dhomë të këshillimit).
- **46** përfaqësime për **masat e sigurimit**.
- Ka nxjerrë **25 urdhëra ekzekutimi** për vendimet gjyqësore.

5.2. Prokurori **Enrik Haxhiraj** :

- **209** përfaqësime për çështje **themeli** (kanë mbetur pa përfunduar duke u mbartur 12 çështje për vitin 2019) dhe ka ushtruar **rekurs për 9** prej tyre,
- **204** përfaqësime për çështje **të veçanta** (kanë mbetur pa përfunduar duke u mbartur 48 çështje për vitin 2019) dhe ka ushtruar **rekurs për 2** prej tyre,
- **120** përfaqësime për **masat e sigurimit**, ka ushtruar **rekurs për 5** prej tyre,
- Ka nxjerrë **31 urdhëra ekzekutimi** për vendimet gjyqësore.
- **16 çështje** i ka **mbartur** për vitin 2018.

5.3. Prokurori **Pelivan Malaj** :

- **208** përfaqësime të akuzës për çështje **themeli** (kanë mbetur pa përfunduar duke u mbartur 48 çështje për vitin 2019) dhe ka ushtruar **rekurs për 20** prej tyre,
- **213** përfaqësime për çështje **të veçanta** (kanë mbetur pa përfunduar duke u mbartur 13 çështje për vitin 2019) dhe ka ushtruar **rekurs për 5** prej tyre,
- **84** përfaqësime për **masat e sigurimit**, ka ushtruar **rekurs për 9** prej tyre,
- Ka nxjerrë **24 urdhëra ekzekutimi** për vendimet gjyqësore.
- **61 çështje** i ka **mbartur** për vitin 2019.

5.4. Prokurori **Kleanth Zeka** :

- **227** përfaqësime të akuzës për çështje **themeli** (kanë mbetur pa përfunduar duke u mbartur 14 çështje për vitin 2019) dhe ka ushtruar **rekurs për 55** prej tyre.
- **215** përfaqësime për çështje **të veçanta** (kanë mbetur pa përfunduar duke u mbartur 13 çështje për vitin 2019) dhe ka ushtruar **rekurs për 7** prej tyre.
- **82** përfaqësime për **masat e sigurimit**, ka ushtruar **rekurs për 11** prej tyre.

- Ka nxjerrë **20 urdhëra ekzekutimi** për vendimet gjyqësore.
- **17 çështje** i ka **mbartur** për vitin 2019.

5.5. Prokurori **Altin Binaj** :

- **85** përfaqësime të akuzës për çështje **themeli** (kanë mbetur pa përfunduar duke u mbartur 4 çështje për vitin 2019) dhe ka ushtruar **rekurs për 4** prej tyre.
- **108** përfaqësime për çështje të **veçanta** (kanë mbetur pa përfunduar duke u mbartur 2 çështje për vitin 2019).
- **91** përfaqësime për **masat e sigurimit**, ka ushtruar **rekurs për 2** prej tyre.
- Ka nxjerrë **22 urdhëra ekzekutimi** për vendimet gjyqësore.
- **6 çështje** i ka **mbartur** për vitin 2019.

6. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË.

Gjatë vitit 2018 edhe personeli administrativ i kësaj zyre, ndonëse mjaft i kufizuar numerikisht, e ka kryer me korrektesë detyrën e vet duke qenë mbështetje për prokurorët në përballimin e kësaj ngarkese në punë.

Në këtë drejtim është për t'u theksuar veçanërisht puna e kryer nga kryesekretarja e kësaj zyre, e cila në mungesë të organikës kryen edhe detyrën e sekretares pranë prokurorëve, si dhe ato të financës dhe të arkivës.

Për vitin 2019 në organikën e Prokurorisë së Apelit Vlorë është shtuar funksioni i sekretares pranë prokurorëve, por në vlerësimin tonë është e domosdoshme që, në vijim, organika të parashikojë edhe funksionet e oficerit të policisë gjyqësore, për përmbushjen më me efikasitet të detyrimeve ligjore kruesisht në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale.

Gjatë vitit 2018, buxheti financiar i kësaj zyre është administruar me korrektesë dhe rigorozitet.

Si pasoje e disiplines financiare dhe ndihmes gjithëvjetore nga Prokuroria e Përgjithshme, nga ana e kësaj Prokurorie buxheti është realizuar thuajse 100% dhe janë likuiduar të gjitha detyrimet ndaj subjekteve të tjerë dhe personelit.

Po ashtu janë mbajtur të gjithë regjistrat financiarë, sipas detyrimeve ligjore dhe udhëzimeve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Financave, ndërkohë që funksionimi i CAMS ende nuk është implementuar pranë kësaj zyre.

Gjatë vitit 2018 respektimi i disiplinës në punë dhe etikës është mbikqyrur nga drejtuesi i kësaj zyre dhe nuk janë hasur problematika në këtë drejtim.

7. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2018.

Nga analiza në tërësi e treguesve që u përmendën më sipër, për vitin 2018 prioritetet kryesore të Prokurorisë së Apelit Vlorë do të jenë si në vijim :

- Përfundimi sa më parë i të gjitha çështjeve penale të mbartura në gjykim.
- Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të përfaqësimit të akuzës në çështjet e ankimuara që janë në fokus të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj, rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhërave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, sidomos ato që lidhen me krimet kundër jetës të kryera me dashje, ato në fushën e krimet ekonomik dhe korrupsionit, kundër rendit e sigurisë publike dhe trafiqeve të të gjitha llojeve, veprat penale kundër drejtësisë, ato që çenojnë sistemin demokratik të zgjedhjeve etj.
- Rritjen e nivelit cilësor të përfaqësimit të akuzës në apel.
- Rritjen e nivelit cilësor të rekurseve në Gjykatën e Lartë.
- Konsolidimi i mëtejshëm i bashkëpunimit shumë të mirë me prokuroritë e rretheve gjyqësore, me strukturat e policisë së shtetit dhe me Prokurorinë e Përgjithshme, pikërisht në funksion të rritjes së cilësisë së përfaqësimit të akuzës në apel.
- Respektimi nga prokurorët i detyrimeve të ligjit procedural penal, ligjit organik të Prokurorisë dhe urdhërave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Ruajtjen e figurës së paster të prokurorëve dhe respektimin prej tyre të normave të solemnitetit në gjykim, etikës dhe të sjelljes së denjë në publik.

DREJTUESI I PROKURORISË

ALTIN BINAJ